

LIGJ
Nr.9356, datë 17.3.2005

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8685, DATË 9.11.2000 "PËR NJË
TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË
NËNTOKË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Të gjithë personat, që përfitojnë trajtim të veçantë, sipas këtij ligji, kanë të drejtë ta marrin atë deri në çastin që plotësojnë kushtet për një lloj përfitimi nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" ose deri kur ata bëhen ekonomikisht aktivë, me përjashtim të personave, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi e blegtori.".

Neni 2

Pas nenit 6 shtohen nenet 6/1 dhe 6/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/ 1

Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen.

Përfitimet e caktuara, sipas këtij ligji, rriten ose indeksohen sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhet në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të trajtimit të veçantë.

Personi, që ka përfituar të ardhura, në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të trajtimit të veçantë.

Neni 6/2

Periudha e përfitimit të trajtimit të veçantë, duke filluar nga data 16.12.2000 e në vazhdim, njihet periudhë sigurimi, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Në këtë rast kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në nivelin minimal, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4530, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**